



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborní Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.494/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtarë me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Elsa Zyberaj dhe Tarion Broshaj, nga radhët e subjektit politik AKR, me seli në Prishtinë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN si të pa rregullta ankesat e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal të Prishtinës, Elsa Zyberaj dhe Tarion Brahaj, nga radhët e subjektit politik AKR, me seli në Prishtinë, me shenjën ZL.Anr.494/2017 dhe ZL.A.nr.495/2017 të datës 24.10.2017, për Zgjedhjet Lokale 2017 të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 24.10.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankes nga kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal Elsa Zyberaj dhe Tarion Brahaj, nga radhët e subjektit politik AKR. Tarion Brahaj pretendon se në Qendrat e Votimit në Prishtinë si në: shkollën fillore “Shkëndija”, 1909e, në shkollën fillore “Hasan Prishtina” 1911c, në shkollën fillore “Ismail Qemajli” 1914e, në shkollën fillore “Naim Frashëri” 1915e, 1924e, në shkollën fillore “Iliria” 1906e, fakulteti filologjik 1901e, shkolla fillore “Meto Bajraktari” 1925e, 1922e, në shkollën fillore “Emin Duraku 1926e, në shkollën fillore “Mitrush Kuteli” 1920e, në shkollën fillore “Zenel Hajdini” 1916e, shkollën fillore “Elena Gjika” 1902e, në shkollën e mesme “Sami Frashëri” është bërë manipulim i votave. Ndërsa, Elsa Zyberaj thekson se në shkollën fillore “Shkëndia” 1927e, shkollën fillore “Hasan Prishtina” 1909e, shkollën fillore “Ismail Qemajli” 1911e, shkollën fillore “Naim Frashëri” 1914e, shkollën fillore “Iliria” 1915e, shkollën fillore “Dardania” 1904e, fakulteti filologjik 1906e, shkollën fillore “Naim Frashëri 1901e, shkollën fillore “Meto Bajraktari 1924e dhe 1925e, shkollën fillore “Emin Duraku 1922e, shkollën fillore “Mitrush Kuteli 1926e, po ashtu pretendon se në këto vendvotime është bërë manipulim i votave.

Paneli në bazë të nenit 8.3 të Rregullat dhe Procedurate PZAP-it, bëri bashkimin e lëndëve të lartëcekura.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të pa rregullta

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesat e parashtruara nga ana e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë Elsa Zyberaj dhe Tarion Broshaj, nga radhët e

subjektit politik AKR, janë të parregullta, sepse nuk janë nënshkruar nga parashtruesit e ankesave dhe si të tilla ankesat nuk i plotësojnë kërkesat e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: “Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”.

Prandaj, PZAP-i nuk u lëshua fare në meritat e ankesave, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL Anr.494/2017 më datën 24.10.2017.



Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.